

Deri te

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Lënda: Parashtrimi i Vendimit për ndryshim dhe plotësim të Statutit

Të nderuar,

Këshilli drejtues i Institutit komunal Universiteti i Punëtorëve “Krste Misirkov” Kërçovë në seancën e rregullt sollti Vendim për ndryshim dhe plotësim të Statutit të institutit, pas udhëzimeve të marra nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, pas ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për kulturën (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/18), nga ju kërkohet pëlqim për zbatim të mëtejshëm të Vendimit.

Me respekt !

Instituti komunal
Universitet i Punëtorëve
“Krste Misirkov” Kërçovë

UD Drejtor

Aneta Gjorgijoska

Mbështetur në nenin 18, pikën 1 të Statutit të Institutit komunal Universiteti i punëtorëve “Krstë Misirkov” Kërçovë nr. (02-64/1) nga data (13,04,2006) ndërsa lidhur me nenin 2 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kulturën (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/18) dhe nenet 1 dhe 9 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kulturën (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/18), Këshilli drejtues i Institutit komunal Universiteti i Punëtorëve “Krstë Misirkov” Kërçovë, në seancën e mbajtur më datë _____ solli këtë

Vendim për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Institutit komunal Universiteti i Punëtorëve “Krstë Misirkov” Kërçovë nr. (02-64/1) më datë (13.04.2006)

Neni 1

Në Statutin e Institutit komunal Universiteti i Punëtorëve “Krstë Misirkov” Kërçovë nr.. (02-64/1) nga data (13,04,2006) neni 14 i statutit ndryshohet si më poshtë:

Për Drejtor të IK Universiteti i Punëtorëve mund të zgjidhet person që përpos kushteve të posaçme të parapara me ligj, përmbush edhe këto kushte të përgjithshme:

- 1) Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) Në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar sanksion kundërvajtës, ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrimit;
- 3) Të ketë fituar 240 kredi sipas EKTS ose të ketë kryer VII/1 shkallën e arsimit të lartë;
- 4) Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune në fushën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave në vepër që ka lidhur;
- 5) Të parashtrij propozim – Program për punën dhe zhvillimin e institutit për katër vitet e ardhshme
- 6) Të ketë një nga certifikatat e njohura ndërkombëtarisht ose ose certifikatë për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFL IBT – më së paku 74 pikë,
 - IELTS – më së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – më së paku nivelin B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS – më së paku 60 pikë ose
 - APTIS – më së paku nivelin B2.

(2) Drejtori që emërohet gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kulturën (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/18) deri më 1 shtator të vitit 2018, detyrohet që të përmbush kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga data e emërimit të tij. Drejtorit që nuk do të përmbush kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin e paraparë me paragrafin 1 të këtij neni i ndërpritet mandati.”

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi me datën e marrjes së pëlqimit nga Këshilli i Komunës së Kërçovës, ndërsa do të publikohet të tabelën e shpalljeve të IK Universiteti i punëtorëve “Krstë Misirkov” Kërçovë.

Kryetar,

Ibrahim Koça